



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 646/3 Prot.

Tiranë, më 22/5 /2017

VENDIM

Nr. 79, datë 22/5 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Av. _____, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 646 Prot., datë 12.04.2017, ndaj Autoritetit Publik “Ministria e Energjisë dhe Industrisë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesi, me shkresën e datës 21.03.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

- a) *Një kopje të marrëveshjes/marrëveshjeve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe Bankers Petroleum.*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 646 Prot, datë 12.04.2017 pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me urdhrin nr. 114 Prot, datë 20.04.2017, ka urdhëruar kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Gjatë inspektimit u konstatua se kërkesa e Qendrës “Res Publica” është depozituar pranë Autoritetit Publik dhe është regjistruar me nr. 1805 Prot., datë 23.03.2017.

Koordinatorja për të Drejtën e Informimit pranë Autoritetit Publik sqaroi grupin e inspektimit se kërkesa e Qendrës “Res Publica” i ka kaluar për trajtim Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve. Kjo e fundit, me shkresën nr. 1805/2 Prot., datë 30.03.2017 i ka kthyer përgjigje ankuesit duke e sqaruar se marrëveshja hidrokarbure ka terma konfidencialiteti dhe nuk mund të bëhet publike pa miratimin e palës tjetër.

Të njëjtin qëndrim mbajti dhe përfaqësuesi i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve i cili informoi grupin e inspektimit se ka një marrëveshje të lidhur nga Shoqëria Saxon International Energy, (sot Bankers Petroleum Albania) me Shoqërinë Albpetrol sh.a, (dhe jo Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë siç citohet në kërkesën për informim) e cila është miratuar me me VKM nr. 477, datë 16.07.2004 të ndryshuar, por nuk mund t'i vihet në dispozicion kërkuarit, sepse në Nenin 23 të saj "Konfidencialiteti", përcaktohet se *"Përveç çka specifikohet ndryshe sipas kësaj Marrëveshje, gjithë informacioni i kryer ose i përfituar ose marrë sipas kësaj Marrëveshje do të mbahet nga Palët konfidencial në mënyrë strikte dhe nuk do të bëhet i ditur pa aprovimin paraprak me shkrim të Palës tjetër për sa kohë që kjo Marrëveshje mbetet në fuqi, përveç se në masën e kërkuar për të vepruar në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret të çdo/ndonjë burse për të cilën Kontraktori mund të jetë subjekt, po që se ky informacion nuk bëhet pjesë e sferës publike nëpërmjet burimesh përveç se Kontraktorit. Për më tepër Kontraktori do të jetë i lidhur me këto detyrime konfidencialiteti për një periudhë prej 5 (pesë) vjet në vijim të mbylljes së kësaj Marrëveshje".*

Nga shqyrtimi i ankimit dhe nga konsultimi i legjislacionit përkatës rezulton se, Albpetrol Sh.A është një shoqëri aksionare me pjesëmarrje tërësisht shtetërore, e autorizuar për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure me shoqëri të treta, në bazë të Marrëveshjes së lidhur me 26.07.1993 me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Sa më sipër informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica", pavarësisht nëse është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".*

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, *"Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".*

Ligji nr. 7746, datë 27.03.1993 "Për hidrokarburet" i ndryshuar, në nenin 3 të tij parashikon se: *"Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar".*

Duke qenë se sipas Ligjit nr. 7746, datë 27.03.1993 "Për hidrokarburet" i ndryshuar, hidrokarburet konsiderohen pronë ekskluzive e shtetit shqiptar dhe si të tilla janë pasuri publike, mosbërja publike e marrëveshjeve hidrokarbure, me pretendimin e ruajtjes së konfidencialitetit, nuk gjen bazë ligjore dhe shkon kundër frymës së ligjit.

Për më tepër, miratimi i marrëveshjes hidrokarbure objekt kërkesë për informim me Vendim të Këshillit të Ministrave (konkretisht Vendimin nr.477 datë 16.07.2004), e bën atë dokument publik dhe si i tillë nuk mund të refuzohet bërja e disponueshme për kërkuarin.

Sa i përket pretendimit lidhur me klauzolën e konfidencialitetit, nëse marrëveshja ka dispozita, shtojca apo anekse të cilat konsiderohen konfidenciale, dokumenti i kërkuar duhet vënë në dispozicion të kërkuarit në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" i cili përcakton se: *"Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".*

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica", kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër lidhur me kufizimet në dhënien e informacionit, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëve shjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankimit nr. 646 Prot., datë 12.04.2017 të Qendrës "Res Publica" kundër Autoritetit Publik "Ministria e Energjisë dhe Industrisë", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informim datë 23.03.2017, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" brenda datës 29.5.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
4. Ky vendim u dha sot në datë 22.5.2017.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI